

A background network diagram consisting of numerous light blue circular nodes of varying sizes connected by thin, light gray lines. The nodes are distributed across the page, with a higher density in the upper left and lower right areas. A large, semi-transparent light blue circle is positioned in the bottom right corner, partially overlapping the network lines.

RRJETI I SHËRBIMEVE **SOCIO-SHËNDETËSORE**

● Bashkia Durrës

RRJETI I
SHËRBIMEVE
SOCIO-SHËNDETËSORE

Bashkia **Durrës**

Hartimi dhe publikimi i këtij dokumenti u realizua me mbështetjen e Projektit “Shëndet për të Gjithë” të Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC”.



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

**Agjencia Zvicerane për Zhvillim
dhe Bashkëpunim SDC**



Tabela e Përmbajtjes

Hyrje	5
Drejtoria e Shërbimit Social, Bashkia Durrës	6
Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror (DRSHSSH), Durrës	10
Qendra Ditore e të Moshuarve (QDM) - Bashkia Durrës	14
Qendra për shërbime mbrojtëse, fuqizuese dhe emergjente për fëmijën dhe familjen	16
Qendra Komunitare për Shërbime Sociale të Integruara për Familjen, Sukth	20
Qendra e Zhvillimit Rezidencial, Durrës	22
Shërbime rezidenciale për fëmijë dhe të rinj me aftësi të kufizuara mendore, sensore dhe fizike	
Qendra Komunitare “Fuqizojmë Komunitetin”	24
Shtëpia e Foshnjës, Durrës	28
Qendra Komunitare Multifunksionale, Nishtullë	32
Qendra Ditore Komunitare Multifunksionale, Rrashbull	36
Qendra e Shërbimeve Komunitare për Fëmijët me Aftësi të Kufizuara	38
Kabineti i Onkologjisë dhe Kujdesit Paliativ, Spitali Rajonal Durrës	42
Shoqata “Ryder Albania” - Shërbim paliativ falas	44
Shërbim infermior privat në banesë - Medical Care Lami	46
Kryqi i Kuq Shqiptar, Dega Durrës	50
Qendër ditore për të moshuarit	
Qendra e Shëndetit Mendor “Drejt Zhvillimit”	52
Qendra “Tek Ura” - Shërbime rehabilitimi shëndetësor dhe të tjera	54
Qendra “Tek Ura” - Shërbime sociale dhe integruese për fëmijët, të rinjtë dhe komunitetin	56
Shtëpia Ortodokse e Shpresës, Shën Vlash	58
Shërbim rezidencial për fëmijë	
Fondacioni “Qendra Kristiane e Durrësit”	60
Qendër ditore për fëmijë dhe të rinj	
Qendra për Zhvillim Komunitar “Sot për të Ardhmen”, Durrës	62
Qendër ditore për shërbime në komunitet	
Qendra Ditore “Nehemia”, Nishtullë, Durrës	66
Njësia e Trajtimit Mbajtës me Metadon (TMM), Spitali Rajonal Durrës	68
Qendra e Ndihmës Juridike Parësore Falas, Durrës	70
Klinika Psikologjike “Butterfly” – Shërbim psikologjik	72

Hyrje

Rrjeti i Shërbimeve Socio-Shëndetësore në Bashkinë Durrës është një nismë e mbështetur nga Projekti “Shëndet për të Gjithë” i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), në zbatim të “Strategjisë Kombëtare të Kujdesit Shëndetësor Parësor” 2020-2025. Dokumenti synon të fuqizojë shërbimin socio-shëndetësor në Kujdesin Shëndetësor Parësor (KSHP) përmes përmirësimit të qasjes dhe cilësisë së shërbimeve sociale, veçanërisht të atyre që synojnë arritjen e popullatave të cenueshme.

Ky dokument përbën një mjet pune që u vjen në ndihmë punonjësve socialë pranë KSHP-së për të lidhur ose referuar pacientët drejt shërbimeve plotësuese, që nuk mund të ofrohen nga Qendrat Shëndetësore. Njëkohësisht, dokumenti u vjen në ndihmë aktorëve të tjerë lokalë të shërbimeve sociale dhe shëndetësore, si Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor, Drejtoria e Shërbimit Social në Bashki, Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror dhe Organizatat e Shoqërisë Civile në Bashkinë Durrës, duke u mundësuar njohjen dhe koordinimin më të mirë të shërbimeve në zonën e tyre të mbulimit.

Rrjeti i Shërbimeve Shëndetësore dhe Sociale në Bashkinë Durrës u përgatit gjatë periudhës kohore tetor 2024 – shkurt 2025.

Për realizimin e këtij dokumenti, falendërojmë Njësinë Vendore të Kujdesit Shëndetësor, Drejtorinë e Shërbimit Social, në Bashki, Drejtorinë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror, Shërbimet e tjera publike dhe jopublike, si edhe Organizatat e Shoqërisë Civile në Bashkinë Durrës, si bashkëpunëtorë të rëndësishëm në jetësimin e këtij procesi.

O Drejtoria e Shërbimit Social, Bashkia Durrës

Lloji i institucionit Publik

Adresa Rruga “Neki Libohova”, Lagjja 17, Durrës

Website: www.durres.gov.al

Përfaqësues ligjor i institucionit **Meme Xhaferaj**
Cel.: 00355 69 63 69 441 | Email: meme.xhaferaj@durres.gov.al

Personi i kontaktit **Meme Xhaferaj**
Cel.: 00355 69 63 69 441 | Email: meme.xhaferaj@durres.gov.al

Mbulimi gjeografik Bashkia Durrës (NJA Urbane: Nr. 1, 2, 3, 4, 5, 6, NJA Rurale: Ishëm, Sukth, Manëz, Katund i Ri, Rrashbull)

Koha e ofrimit të shërbimit Prej vitit 2014

INFORMACION MBI LLOJIN E SHËRBIMEVE

Qëllimi i shërbimit

- Të fuqizojë dhe integrojë grupet e pafavorizuara në Bashkinë Durrës.

Fushat e shërbimeve

- Planifikim, administrim dhe monitorim i shërbimeve sociale në bashkinë Durrës.
- Koordinim i shërbimeve parashoqërore dhe multifunksionale për grupet në nevojë.

Llojet e shërbimeve

- Monitoron dhe menaxhon rastet e fëmijëve viktime të dhunës, abuzimit dhe keqtrajtimit.
- Koordinon funksionimin e Grupit Teknik Multidisiplinor (GTM) për rastet e fëmijëve në rrezik.
- Koordinon funksionimin e Ekipit Teknik Multidisiplinor (ETN) për rastet e dhunës në familje.
- Koordinon “Shërbimin e urgjencës për rastet e dhunës në familje”.
- Evidenton nevojat e grupeve vulnerabël përmes vlerësimit të gjendjes reale social-ekonomike, përfshirë përzgjedhjen dhe pagesat e përfituesve të skemës së ndihmës ekonomike (NE).
- Jep informacion mbi dokumentacionin e nevojshëm për t’u regjistruar në shtëpitë e të moshuarve, mbledh dhe paraqet dosjet në Drejtorinë Rajonale të Shërbimit Social Durrës.

GRUPET PËRFITUESE

Kategoritë përfituese

- Fëmijët
- Të moshuarit
- Të rriturit
- Gratë dhe vajzat
- Familjet

Kriteret kualifikuese

Fëmijët:

- fëmijë jetimë, të braktisur ose pa kujdes prindëror
- fëmijë në situatë rruge, në konflikt me ligjin, ose viktimë të dhunës, abuzimit apo shfrytëzimit

Të moshuarit:

- të moshuar mbi 65 vjeç;
- të moshuar të vetmuar
- të moshuar në kushte të vështira ekonomike, sociale
- të moshuar pa pasuri dhe prona

Të rriturit:

- persona me aftësi të kufizuar
- invalidë të punës (sipas vlerësimit nga KMCAP¹)
- të papunë

Gratë dhe vajzat:

- gra dhe vajza viktimë të dhunës në familje (dhe fëmijët e tyre) të pajisur ose jo me urdhër mbrojtjeje
- gra dhe vajza në vështirësi sociale dhe ekonomike
- gra nga komunitete të marginalizuara (romë/egjiptianë/migrantë)

Familjet:

- familje në vështirësi ekonomike dhe sociale

Identifikimi i përfituesve

Përmes:

- Mekanizmit të koordinuar të referimit (përfshirë administratorët socialë)
- Komisionit mjekësor të caktimit të aftësisë për punë
- Institucioneve të tjera lokale publike dhe private, OJF-ve, individëve.

INFORMACION ADMINISTRATIV

Numri i punonjësve

- 55 punonjës (11 administratorë socialë, staf menaxherial dhe teknik)

Burime të tjera të ardhurash

- Bashkia Durrës
- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (përmes fondit social)

¹ Komisioni Mjekësor për Caktimin e Aftësisë për Punë të Invalidëve

○ Pagesa nga përfituesit	➤ Organizata jofitimprurëse
○ Koordinimi me shërbime të tjera	➤ Nuk ka
○ Financuesi i shërbimit	➤ Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror, Durrës ➤ Zyra Vendore Arsimore, Durrës ➤ Policia e Shtetit ➤ Gjykata/Prokuroria ➤ Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor ➤ Zyra Rajonale e Punësimit ➤ Drejtoria e Formimit Profesional ➤ Organizatat Jofitimprurëse lokale dhe ndërkombëtare ➤ Organizata me bazë fetare

○ Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror (DRSHSSH), Durrës

Lloji i institucionit	Publik
Adresa	Rruga “Aleksandër Goga”, Lagjja 11, Durrës
Përfaqësues ligjor i institucionit	Petrit Ismailati Email: petrit.ismailati@sherbimisocial.gov.al
Personi i kontaktit	Fationa Halili Email: fationa.halili@sherbimisocial.gov.al
Mbulimi gjeografik	Qarku i Durrësit (<i>Bashkia Durrës, Bashkia Krujë, Bashkia Shijak</i>)
Koha e ofrimit të shërbimit	Prej vitit 1993

○ INFORMACION MBI LLOJIN E SHËRBIMEVE

Qëllimi i shërbimit	➤ Të rrisë cilësinë e jetës dhe të promovojë përfshirjen sociale për personat vulnerabël në qarkun e Durrësit.
Fushat e shërbimeve	➤ Shërbime shoqërore (Institucione të përkujdesjes sociale) ➤ Shërbime të pagesave për Ndihmën Ekonomike (NE) dhe Aftësinë e Kufizuar (AK)
Llojet e shërbimeve	Shërbime shoqërore (Institucione të përkujdesjes sociale): ➤ Monitorim të standardeve të shërbimeve sociale në rajon të ofruara nga Institucionet e Përkujdesjes Sociale, publike dhe jo publike, rezidenciale dhe ditore. ➤ Kryerja e vlerësimit bio-psiko-social për personat me AK. ➤ Strehim për individët në nevojë. Shërbime të pagesave për NE dhe AK: ➤ Planifikon dhe administron fondet e ndihmës ekonomike (shqyrtimi i dosjeve të përfituesve). ➤ Planifikon dhe administron fondet e pagesës për personat me aftësi të kufizuar (shqyrtimi i dosjeve të përfituesve).
Shërbimet e monitoruara nga DRSHSSH Durrës	Shërbimet sociale për fëmijët ➤ Shërbime rezidenciale për fëmijë (2 qendra) ➤ Shërbime ditore për fëmijë (5 qendra)

Shërbime për personat me aftësi të kufizuar

- Shërbime rezidenciale për fëmijë PAK (1 qendër)
- Shërbime ditore për fëmijë PAK (1 qendër)

Shërbime sociale për gra të dhunuara/viktima trafikimi

- Shërbime rezidenciale & ditore (1 qendër)
- Shërbime ditore rehabilituese dhe integruuese (2 qendra)

Shërbime sociale për të moshuarit:

- Shërbime ditore për të moshuar (2 qendra)

Shërbime të tjera komunitare:

- Qendra ditore Nehemia, Durrës
- Qendra e reziliencës “Fuqizojmë Komunitetin”
- Qendra për zhvillim komunitar “Sot për të Ardhmen”
- Qendra e shëndetit mendor “Drejt Zhvillimit”

GRUPET PËRFITUESE

Kategoritë përfituese

- Familjet/individët
- Personat me aftësi të kufizuar
- Fëmijët
- Të moshuarit
- Gratë e dhunuara/viktima të trafikimit

Kriteret kualifikuese

Për përfituesit e ndihmës ekonomike:

- Familje apo individë pa të ardhura apo me të ardhura të pamjaftueshme
- Familje apo individë që nuk zotërojnë pasuri të paluajtshme (shtëpi të dyta, makinë)
- Të papunë, kryefamiljarë

Për përfituesit e pagesës së aftësisë së kufizuar:

- Të kenë një aftësi të kufizuar të njohur nga komisionet mjekësore të vlerësimit.
- Të kenë shkallë invaliditeti që kërkon mbështetje financiare ose shërbime speciale.
- Të mos kenë kujdestarë ose mbështetje të mjaftueshme nga familja.
- Të jenë rezidentë në qarkun e Durrësit.

Për fëmijët:

- Jetimë që nuk janë në institucione
- Fëmijë të braktisur ose pa kujdes prindëror
- Fëmijë që vijnë nga familje në kushte të vështira sociale dhe ekonomike
- Fëmijë me aftësi të kufizuara
- Fëmijë të vendosur në shërbimin e kujdestarisë
- Përmes shërbimeve publike të përkujdesjes dhe mbështetjes sociale në rajon

- **Identifikimi i përfituesve**
 - Për të moshuarit:
 - Të moshuar mbi 65 vjeç
 - Të moshuar pa përkujdesje familjare
 - Të moshuar që jetojnë vetëm dhe në nevojë për kujdes social ose shëndetësor
 - Të moshuar që nuk zotërojnë pasuri të paluajtshme (tokë, shtëpi)
 - Për gra të dhunuara/viktima të trafikimit:
 - Gra viktima të dhunës në familje dhe trafikimit
 - Të regjistruara si viktima të dhunës ose trafikimit nga institucionet përgjegjëse
 - Në nevojë për strehim emergjent, mbështetje psikologjike ose ndihmë ligjore

○ INFORMACION ADMINISTRATIV

- **Numri i punonjësve**
 - 17 punonjës (1 drejtues, 2 finacierë, 5 punonjës socialë, 1 jurist, 1 specialist i teknologjisë së informacionit, 3 mjekë, 1 përgjegjës, 3 operatorë për hedhje të dhënash)
- **Financuesi i shërbimit**
 - Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
- **Burime të tjera të ardhurash**
 - Kontribute nga donacione
- **Pagesa nga përfituesit**
 - Nuk ka
- **Koordinimi me shërbime të tjera**
 - Drejtoritë e shërbimeve sociale në bashkitë e qarkut Durrës
 - Njësitë administrative
 - Mjekët e familjes dhe specialistët e skemës së AK-ës
 - Institucione të tjera publike dhe jopublike
 - Inspektorati i punës
 - Organizata ndërkombëtare dhe lokale në fuqizim të komuniteteve

○ Qendra Ditore e të Moshuarve (QDM) - Bashkia Durrës

Lloji i institucionit	Publik
Adresa	Rruga “Neki Libohova”, Lagjja 17, Ish URT, Durrës
Përfaqësues ligjor i institucionit	Megi Hasani Cel.: 00355 69 84 97 767 Email: hasani.megi@yahoo.com
Personi i kontaktit	Elida Rrudha Cel.: 00355 67 22 77 117 Email: elidarrudha@gmail.com
Mbulimi gjeografik	Qyteti i Durrësit
Koha e ofrimit të shërbimit	Prej vitit 2002

○ INFORMACION MBI LLOJIN E SHËRBIMEVE

- **Qëllimi i shërbimit**
 - Të përmirësojë cilësinë e jetës për të moshuarit dhe të kontribuojë në integrimin dhe shmangien e izolimit dhe përjashtimit social.
- **Fushat e shërbimeve**
 - Shërbime ditore psiko-sociale
 - Shërbime shëndetësore (*ambulatorë në mjediset e qendrës*)
 - Shërbime mbështetëse
- **Llojet e shërbimeve**
 - Shërbime ditore psiko-sociale:**
 - Shërbime ditore për të moshuarit (socializim, integrim, argëtim) në mjediset e qendrës dhe jashtë saj.
 - Ofrim i një vakti të plotë ushqimor (drekë).
 - Shërbime sanitare, lavanderi dhe dushe për të moshuarit në qendër.
 - Biseda individuale dhe në grup me të moshuarit rreth menaxhimit të stresit, vetmisë, shëndetit mendor, marrëdhënieve familjare, humbjes së një prej bashkëshortëve, etj.
 - Shërbime shëndetësore ambulatorë:**
 - Ndihmë në monitorimin e sëmundjeve kronike, matje të tensionit arterial, monitorim të parametrave vitale, administrim i medikamenteve, etj.
 - Edukim shëndetësor rreth (aktivitetit fizik, ushqyerjes së shëndetshme, menaxhimit të sëmundjeve kronike, parandalimit të rrëzimeve në kushtet e shtëpisë, etj.).
 - Injeksione apo mjekime plagësh të thjeshta.
 - Menaxhim i emergjencave shëndetësore në qendër.

Shërbime mbështetëse:

- Ndhimë për hartim dokumentacioni dhe përfitimet sociale.
- Këshillim për të drejtat e pensionistëve dhe shërbime ligjore bazë.

GRUPET PËRFITUESE

- **Kategoritë përfituese**
 - Të moshuar që kanë mbushur moshën e daljes në pension
- **Kriteret kualifikuese**
 - Të moshuar që jetojnë vetëm dhe janë të izoluar nga shoqëria
 - Të moshuar me vështirësi social-ekonomike
- **Identifikimi i përfituesve**

Përmes:

 - Drejtorisë së Shërbimit Social në Bashki dhe Njësitë Administrative
 - Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror
 - Qendrave të Kujdesit Shëndetësor Parësor
 - Organizatave të Shoqërisë Civile
 - Komunitetit dhe vetëreferimeve në qendër

INFORMACION ADMINISTRATIV

- **Numri i punonjësve**
 - 16 punonjës (1 drejtues, 1 financier, 4 punonjës socialë, 1 infermier, 1 mjek me kohë të pjesshme, 1 koordinator projekti, 2 kuzhinierë, 2 sanitarë, 1 shofer, 2 roja)
- **Financuesi i shërbimit**
 - Bashkia Durrës
- **Burime të tjera të ardhurash**
 - Shërbime vullnetare nga të rinjtë, etj.
- **Pagesa nga përfituesit**
 - Nuk ka
- **Koordinimi me shërbime të tjera**
 - Shkolla dhe gjimnaze publike dhe jo publike të qytetit
 - Të rinj nga Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës
 - Misionarë të Kishave
 - Qendra e Zhvillimit Rezidencial, Durrës
 - Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor, Durrës
 - Qendra e Formimit Profesional
 - OJF që punojnë në bashkinë Durrës e më tej (Misioni pa Kufi, Durrësi Aktiv, Qendra Komunitare Sot për të Ardhmen).

Qendra për shërbime mbrojtëse, fuqizuese dhe emergjente për fëmijën dhe familjen

Lloji i institucionit Publik

Adresa Rruga “Bajram Tusha”, Lagjja 14, Shkozë, Durrës

Përfaqësues ligjor i institucionit **Malvina Dunga**
Cel.: 00355 67 20 70 548 | Email: malvinakeci@yahoo.com

Personi i kontaktit **Malvina Dunga**
Cel.: 00355 67 20 70 548 | Email: malvinakeci@yahoo.com

Mbulimi gjeografik Njësia Administrative Nr. 5, Shkozë, Bashkia Durrës

Koha e ofrimit të shërbimit Prej vitit 2020

INFORMACION MBI LLOJIN E SHËRBIMEVE

Qëllimi i shërbimit

- Të kontribuojë në mirëqenien dhe përfshirjen shoqërore të fëmijëve, të rinjve dhe familjeve të tyre në situatë vulnerabël dhe në nevojë për kujdes shoqëror.

Fushat e shërbimeve

- Shërbime emergjente
- Shërbime sociale në komunitet (për mbrojtjen e fëmijëve, fuqizimin e familjes, mbështetjen dhe zhvillimin e komunitetit)

Shërbimi i emergjencës synon mbrojtjen dhe strehimin e çdo fëmije dhe familjes së tij/saj, në situatë emergjente, kërcënuese për jetën dhe shëndetin.

Llojet e shërbimeve

Shërbime emergjente:

- Shërbim emergjent i mbrojtjes 72 + orë për fëmijët dhe familjet e tyre, në nevojë për mbrojtje të menjëhershme.
- Mbulim i nevojave ushqimore, shëndetësore, higjieno-sanitare, apo për materiale të buta, etj.
- Menaxhimi i problemeve të shëndetit mendor të fëmijëve në shërbimin emergjent.
- Shërbime mbrojtëse (menaxhim rasti) dhe monitorim i rasteve në menaxhim.

Shërbime sociale në komunitet:

Për mbrojtjen e fëmijëve:

- Identifikim dhe mbrojtje e fëmijëve dhe familjeve në rrezik nga abuzimi, neglizhenca apo dhuna.
- Shërbim komunitar i integruar për mbrojtjen e fëmijëve përmes referimit, vlerësimit të nevojave të fëmijës dhe familjes përmes vizitave në familje, menaxhimit dhe monitorimit të rasteve, adresimit të dhunës me bazë gjinore, etj.

Për fuqizimin e familjes:

- Programe për fuqizimin e prindërve
- Këshillim psikologjik për prindërit dhe fëmijët (terapi grupi dhe/ose këshillim individual).
- Shërbime mbështetëse për familjen në komunitet (paketa ushqimore dhe higjieno-sanitare; mbështetje administrative, ligjore etj.).

Për mbështetje dhe zhvillim të komunitetit:

- Programe për fuqizim të individëve dhe familjeve (këshillim, edukim, trajnim dhe ndërmjetësim mbi punësimin, orientimin e karrierës dhe aspektet ligjore).

GRUPET PËR FITUESE

Kategoritë përfituese

- Fëmijët
- Familjet e fëmijëve në nevojë
- Individët / prindërit
- Komuniteti

Kriteret kualifikuese

Fëmijët dhe familjet e tyre:

- Fëmijë dhe familje në situata të rrezikuara, subjekte të dhunës, abuzimit, neglizhencës ose shfrytëzimit.
- Fëmijë dhe familje në situata emergjente për strehim të përkohshëm, ushqim, veshje, etj.
- Fëmijë dhe familje me nevoja psiko-sociale dhe ekonomike të vështira.

Individët/komuniteti:

- Individët, komunitetet, në situata emergjente për strehim të përkohshëm, ushqim, veshje, etj.
- Individët, komunitetet, në nevojë për mbrojtje, punësim, edukim, ndërmjetësim, fuqizim, etj.

Identifikimi i përfituesve

Përmes:

- Punës në terren të stafit të Qendrës
- Shërbimit Social në Bashki
- Organizatave të Shoqërisë Civile

INFORMACION ADMINISTRATIV

Numri i punonjësve

- 6 punonjës (1 drejtues, 1 punonjës social, 2 psikologë, 1 punonjës shërbimi, 1 shofer)

Financuesi i shërbimit

- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
- Bashkia Durrës

Burime të tjera të ardhurash

- World Vision

○ Pagesa nga përfituesit	➤ Nuk ka
○ Koordinimi me shërbime të tjera	➤ Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror ➤ Shërbimet e Kujdesit Shëndetësor Parësor e Spitalor ➤ Zyra e Punës ➤ Institucionet arsimore ➤ Shërbime të tjera private me veprimtari në Bashkinë Durrës ➤ Organizatat e Shoqërisë Civile

Qendra Komunitare për Shërbime Sociale të Integruara për Familjen, Sukth

Lloji i institucionit	Bashkëpunim Publik + Organizatë e Shoqërisë Civile
Adresa	Njësia Administrative Sukth
Përfaqësues ligjor i institucionit	Meme Xhaferaj Cel.: 00355 69 63 69 441 Email: meme.xhaferaj@durres.gov.al
Personi i kontaktit	Edlir Cerri Cel.: 00355 69 66 61 50 39 Email: edlir.cerri@durres.gov.al Nesila Jaho Cel.: 00355 67 35 66 578 Email: nesila.jaho@durres.gov.al E-mail: npftirana@gmail.com
Mbulimi gjeografik	Njësia Administrative Sukth (përfshirë fshatrat Sukth i Ri, Vadardhë Kullë, Hamallaj, Perlat, Rrushkull)
Koha e ofrimit të shërbimit	Prej vitit 2022

INFORMACION MBI LLOJIN E SHËRBIMEVE

Qëllimi i shërbimit	➤ Të fuqizojë zhvillimin social-ekonomik të komuniteteve në nevojë në Njësinë Administrative Sukth.
Fushat e shërbimeve	➤ Shërbime psiko-sociale ➤ Shërbime punësimi
Llojet e shërbimeve	Shërbime psiko-sociale: ➤ Këshillim psikosocial për fëmijët me probleme social-ekonomike. ➤ Aktivitete ndërgjegjësuëse mbi zhvillimin e komunitetit (<i>dhuna në familje, abuzimi, qasja në sistemin arsimor, emigracioni, etj.</i>). ➤ Mbështetje me paketa ushqimore apo veshmbathje për rastet emergjente. ➤ Mbështetje me mjete shkollore për fëmijët e familjeve me mundësi të pakta ekonomike. ➤ Menaxhim rasti për adresim të nevojave sociale (identifikim, referim, monitorim). Shërbime punësimi: ➤ Ndërmjetësim, referim dhe mbështetje për qasje në kurse profesionale apo praktika pune për të rinjtë. ➤ Ofrim dhe mbështetje me pajisje profesionale për të rinjtë që synojnë të punësohen apo vetë-punësohen.

GRUPET PËRFITUESE

- **Kategoritë përfituese**
 - Fëmijët
 - Të rinjtë
 - Familjet
- **Kriteret kualifikuese**
 - Banorë të Njesisë Administrative Sukth
 - Fëmijë nga familje me probleme social-ekonomike
 - Të rinj në nevojë për punësim dhe në kushte vulnerabiliteti social
 - Familje me probleme social-ekonomike
- **Identifikimi i përfituesve**

Përmes:

 - Administratorit shoqëror të Ndihmës Ekonomike
 - Institucioneve arsimore (shkolla, kopshte)
 - Identifikimit në terren nga punonjësit e qendrës
 - Qendrës Shëndetësore Sukth
 - Kryeplakut të Njesisë Administrative Sukth
 - Organizatave të shoqërisë civile

INFORMACION ADMINISTRATIV

- **Numri i punonjësve**
 - 2 punonjës (1 punonjës social, 1 psikolog)
- **Financuesi i shërbimit**
 - Bashkia Durrës
 - UNDP përmes Fondacionit “Ndihmë për fëmijët”
- **Burime të tjera të ardhurash**
 - Nuk ka
- **Pagesa nga përfituesit**
 - Nuk ka
- **Koordinimi me shërbime të tjera**
 - Qendra Shëndetësore, Sukth
 - Zyra Vendore Arsimore
 - Zyra e Punës
 - Qendra e Formimit Profesional
 - Biznese private
 - Organizata të shoqërisë civile
 - Policia e shtetit

○ Qendra e Zhvillimit Rezidencial, Durrës

Shërbime rezidenciale për fëmijë dhe të rinj me aftësi të kufizuara mendore, sensore dhe fizike

Lloji i institucionit	Publik
Adresa	Rruga "Marta Buda", Lagjja 12, Durrës Telefon.: 00355 52 222 658
Përfaqësues ligjor i institucionit	Mimoza Xhengo Cel.: 00355 68 20 89 535
Personi i kontaktit	Mimoza Xhengo Cel.: 00355 68 20 89 535
Mbulimi gjeografik	Kombëtar
Koha e ofrimit të shërbimit	Prej vitit 1992

○ INFORMACION MBI LLOJIN E SHËRBIMEVE

- **Qëllimi i shërbimit**
 - Të mbështesë zhvillimin dhe integrimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara mendore, sensore dhe fizike përmes kujdesit të specializuar.
- **Fushat e shërbimeve**
 - Shërbime rezidenciale
 - Shërbime shëndetësore dhe rehabilituese
 - Shërbime psiko-sociale
 - Shërbime edukative
- **Llojet e shërbimeve**
 - Shërbime rezidenciale:**
 - Shërbim rezidencial (fjetje, ushqim, higjienizim) për fëmijë/të rinj me aftësi të kufizuara mendore, sensore dhe fizike të moshës 3 - 25 vjeç.
 - Asistencë në aktivitetet e përditshme dhe përmirësimin e nevojave personale.
 - Shërbime shëndetësore dhe rehabilituese:**
 - Monitorim dhe kujdes mjekësor i vazhdueshëm.
 - Administrim i medikamenteve.
 - Fizioterapi - ushtrime dhe terapi fizike për të përmirësuar lëvizshmërinë dhe forcën muskulare.
 - Rehabilitim pas dëmtimeve ose operacioneve.
 - Logopedi - terapi e të folurit për të përmirësuar aftësitë komunikuese.
 - Ushtrime për zhvillimin e gjuhës dhe artikulimit.

Shërbime psiko-sociale:

- Këshillim dhe mbështetje emocionale për përfituesit.
- Hartim i planeve individuale të zhvillimit personal.

Shërbime edukative:

- Mësimdhënie nga edukatorë të specializuar për të zhvilluar aftësitë akademike dhe jetësore.
- Aktivitete edukative dhe kreative për të nxitur pavarësinë dhe integrimin social.

GRUPET PËRFITUESE

Kategoritë përfituese	➤ Fëmijët ➤ Të rinjtë
Kriteret kualifikuese	➤ Fëmijë dhe të rinj të moshës 3 – 25 vjeç ➤ Fëmijë dhe të rinj me aftësi të kufizuara mendore, sensore dhe fizike të theksuara, që nuk janë në gjendje të kujdesen për veten dhe nuk mund të marrin kujdesin e nevojshëm nga familjarët. ➤ Fëmijë dhe të rinj që nuk kanë mundësi për integrim të plotë në familje ose komunitet për shkak të gjendjes së tyre shëndetësore dhe sociale. <i>Pas moshës 25 vjeç, përfituesit e qendrës ose kthehen në familjet e tyre biologjike, ose transferohen në institucione të tjera që ofrojnë shërbime për të rriturit me aftësi të kufizuara.</i>
Identifikimi i përfituesve	Përmes: ➤ Drejtorisë së Shërbimit Social në Bashki ➤ Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror ➤ Shërbimeve të kujdesit shëndetësor parësor dhe spitalor

INFORMACION ADMINISTRATIV

Numri i punonjësve	➤ 28 punonjës (1 drejtor, 3 përgjegjës sektori, 1 fizioterapeut, 1 logoped, 4 edukatorë, 3 infermierë, 12 kujdestarë, 3 sanitarë)
Financuesi i shërbimit	➤ Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ➤ Shërbimi Social Shtetëror
Burime të tjera të ardhurash	➤ Nuk ka
Pagesa nga përfituesit	➤ Nuk ka
Koordinimi me shërbime të tjera	➤ Drejtoria e Shërbimit Social në Bashki ➤ Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror ➤ Shërbimet e kujdesit shëndetësor parësor dhe spitalor ➤ Organizata të shoqërisë civile

Qendra Komunitare “Fuqizojmë Komunitetin”

Lloji i institucionit	Bashkëpunim Publik + Organizatë e shoqërisë civile
Adresa	Rruga “Egnatia”, Lagjja 3, Durrës Facebook: Qendra Fuqizojmë Komunitetin Durrës
Përfaqësues ligjor i institucionit	Fabiola Laço Cel.: 00355 69 40 94 622 Email: fabiolaegro@gmail.com
Personi i kontaktit	Viola Cikalleshi Cel.: 00355 69 36 51 315 Email: cikalleshi.viola@gmail.com
Mbulimi gjeografik	Bashkia Durrës (me njësitë administrative)
Koha e ofrimit të shërbimit	Prej vitit 2023

INFORMACION MBI LLOJIN E SHËRBIMEVE

Qëllimi i shërbimit	➤ Të fuqizojë komunitetet vulnerabël përmes shërbimeve të integruara të kujdesit social.
Fushat e shërbimeve	➤ Shërbime sociale ➤ Shërbime rehabilituese shëndetësore
Llojet e shërbimeve	Shërbime sociale: ➤ Fuqizim i individëve dhe familjeve (<i>programe të prindërimit pozitiv, mentorim për fuqizim ekonomik, programe të rritjes së qasjes ndaj shërbimeve, forcim i rrjeteve profesionale, etj.</i>). ➤ Advokim, lobim, informim dhe edukim i komunitetit. ➤ Parandalim i dhunës në marrëdhëniet familjare (<i>edukim, informim, ndërgjegjësim i komunitetit, individëve</i>). ➤ Qendër ditore për edukim passhkollor për fëmijët, në sistemin shkollor 9-vjeçar. ➤ Kampe verore për fëmijët ➤ *<i>Bootcamps</i> për të rinjtë ➤ Shoqërim, orientim, asistencë për qasje në shërbime për personat vulnerabël, përfshirë të moshuarit. ➤ Shërbim ligjor dhe psikologjik falas për viktimat e dhunës në familje.

* Një trajnim i shkurtër, intensiv dhe praktik që synon t'u mësojë pjesëmarrësve aftësi të reja në një kohë të shkurtër.

Shërbime rehabilituese shëndetësore:

- Shërbim lëvizës në familje për mbështetje psikologjike dhe terapi të të folurit (logopedi).
- Terapi të të folurit për fëmijët 0-18 vjeç në qendër.
- Terapi zhvillimi fizik për fëmijët 0-18 vjeç në qendër.
- Fizioterapi për fëmijë dhe të rritur.
- Terapi grupi dhe okupacionale për fëmijët 0-18 vjeç.

GRUPET PËRFITUESE

Kategoritë përfituese

- Fëmijët
- Të rinjtë
- Gratë
- Të moshuarit
- Familjet / Komuniteti

Kriteret kualifikuese

Fëmijët dhe të rinjtë:

- Fëmijë në rrezik abuzimi, neglizhimi, ose shfrytëzimi
- Fëmijë të ndarë nga familjet
- Fëmijë në sistemin shkollor 9-vjeçar
- Fëmijë në rrezik për braktisje të shkollës
- Adoleshentë dhe të rinj vulnerabël

Gratë dhe vajzat:

- Gra që kanë përjetuar abuzim fizik, psikologjik, seksual ose ekonomik nga partnerët e tyre ose anëtarë të tjerë të familjes.

Të moshuarit:

- Të moshuar vulnerabël (*subjekte të varfërisë, izolimit social, neglizhencës, pamundësisë shëndetësore, mungesës së rrjetit mbështetës*).

Familjet dhe komuniteti:

- Familje me të ardhura të pakta
- Pakica etnike dhe fetare
- Familje të personave me aftësi të kufizuar

Identifikimi i përfituesve

Përmes:

- Institucioneve koordinuese (sikundër përshkruhet më poshtë)
- Identifikimit në terren nga stafi i qendrës
- Kontaktit të drejtpërdrejtë me shërbimet tona

INFORMACION ADMINISTRATIV

Numri i punonjësve

- 20 punonjës (3 staf menaxherial, 1 drejtues teknik, 1 financier, 2 staf mbështetës, 2 psikologë, 1 punonjës social, 3 terapistë/logopedë, 1 fizioterapeut, 2 mentorë të fuqizimit ekonomik, 1 koordinator ndërsektorial, 1 punonjës terreni)

Financuesi i shërbimit	➤ Bashkia Durrës ➤ Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (fondi social)
Burime të tjera të ardhurash	➤ UNDP
Pagesa nga përfituesit	➤ Nuk ka
Koordinimi me shërbime të tjera	➤ Qendra për Zhvillim Komunitar “Sot për të Ardhmen” ➤ Shërbimi Social, Bashkia Durrës ➤ Zyra Vendore Arsimore ➤ Njësia vendore e Kujdesit Shëndetësor ➤ Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror ➤ Sistemi i drejtësisë (Policia, Gjykata, etj.) ➤ Prefektura

O Shtëpia e Foshnjës, Durrës

Lloji i institucionit Publik

Adresa Rruga "Asti Nushi", Lagjja Nr.14, Njësia Administrative Shkozet, Durrës

Përfaqësues ligjor i institucionit **Mimoza Xhelilaj**
Cel.: 00355 68 63 06 720 | Email: mimoza.xhelilaj@durres.gov.al;
mimozakapo@gmail.com

Personi i kontaktit **Mimoza Xhelilaj**
Cel.: 00355 68 63 06 720 | Email: mimoza.xhelilaj@durres.gov.al;
mimozakapo@gmail.com

Mbulimi gjeografik Kombëtar

Koha e ofrimit të shërbimit Prej vitit 1957

● INFORMACION MBI LLOJIN E SHËRBIMEVE

● Qëllimi i shërbimit

- Të kontribuojë në mirërritjen e fëmijëve 0-6 vjeç pa kujdes prindëror ose nga familje në nevojë si dhe në riintegrimin e tyre në familjet biologjike ose në alternativa të tjera të kujdesit.

● Fushat e shërbimeve

- Shërbime rezidenciale (24/7) për fëmijët e moshave 0-6 vjeç
- Shërbime mbështetëse për familjen
- Shërbime të birësimit apo alternativa të tjera të kujdesit

● Llojet e shërbimeve

Shërbime rezidenciale (24/7) për fëmijët e moshave 0-6 vjeç:

- Strehim, ushqim dhe higjienizim për fëmijët në rezidencë.
- Kujdes shëndetësor dhe ndjekje pediatrike në mbështetje të zhvillimit të shëndetshëm të fëmijëve.
- Shërbime psiko-sociale për mirërritjen dhe mbështetjen emocionale dhe psikologjike të fëmijëve.
- Shërbime edukative dhe zhvillimore për të ndihmuar në zhvillimin kognitiv dhe social të fëmijëve.

Shërbime mbështetëse për familjen:

- Shërbime këshillimi për familjet në mbështetje të riintegrit të fëmijëve.
- Shërbime ditore për fëmijët 3-6 vjeç, në ndihmë të familjeve me të ardhura të pakta për të shmangur braktisjen e fëmijëve.
- Mbështetje e familjes me mjete jetese (paketa ushqimore dhe veshmbathje) për parandalimin e braktisjes së fëmijëve.

Shërbime të birësimit, apo alternativa të tjera të kujdesit:

- Shërbime të birësimit dhe integritit të fëmijëve në familje birësuese.
- Ndërmjetësim për riatdhësim dhe bashkim me familjen biologjike.
- Shqyrtim dhe ndërmjetësim për alternativa të tjera integruese në familje për fëmijët (p.sh. familjet kujdestare).

GRUPET PËRFITUESE

Kategoritë përfituese

- Fëmijët
- Familjet

Kriteret kualifikuese

Fëmijët në kujdes rezidencial:

- Fëmijë të braktisur, jetimë, pa përkujdesje prindërore
- Fëmijë në rrezik abuzimi, trafikimi ose shfrytëzimi

Fëmijët në shërbime ditore:

- Fëmijë që kanë prindër me aftësi të kufizuara ose probleme shëndetësore.
- Fëmijë me probleme shëndetësore ose aftësi të kufizuara.

Fëmijët në proces birësimi ose kujdestarie:

- Fëmijë të braktisur, me vendim ligjor
- Fëmijë që përmbushin kriteret e ligjit për birësim
- Fëmijë në proces vlerësimi për një familje adoptuese ose kujdestare

Familjet përfituese:

- Familje me vështirësi sociale dhe ekonomike
- Familje me prindër me aftësi të kufizuara

Identifikimi i përfituesve

Përmes:

- Policisë dhe institucioneve të drejtësisë
- Shërbimit Social Shtetëror (kombëtar)
- Institucioneve të kujdesit shëndetësor parësor dhe spitalor
- Drejtorisë së Shërbimeve Sociale në Bashki
- Organizatave të shoqërisë civile
- Komunitetit

INFORMACION ADMINISTRATIV

Numri i punonjësve

- 29 punonjës (1 drejtues, 1 financier, 3 punonjës socialë, 1 mjek, 21 kujdestarë, 1 mirëmbajtës/shofer, 1 rojë)

Financuesi i shërbimit

- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

- **Burime të tjera të ardhurash**
 - ▾ Donatorë privatë
 - ▾ Organizata të shoqërisë civile
- **Pagesa nga përfituesit**
 - ▾ Nuk ka
- **Koordinimi me shërbime të tjera**
 - ▾ Me institucionet për identifikim të përfituesve (të lartpërmendura)

Qendra Komunitare Multifunkzionale, Nishtullë

Lloji i institucionit Publik

Adresa Rruga "Kepi Rodonit", Lagjja 14, Nishtullë, Durrës
Facebook: [Qendra Komunitare Multifunkzionale Nishtulla](#)

Përfaqësues ligjor i institucionit **Ariola Baballëku**
Cel.: 00355 69 54 22 433 | Email: ariolababalleku4@gmail.com

Personi i kontaktit **Ariola Baballëku**
Cel.: 00355 69 54 22 433 | Email: ariolababalleku4@gmail.com

Mbulimi gjeografik Njësia Administrative Nr. 5, Lagjja 14, Nishtullë, Durrës

Koha e ofrimit të shërbimit Prej vitit 2013

INFORMACION MBI LLOJIN E SHËRBIMEVE

Qëllimi i shërbimit

- Të përmirësojë cilësinë e jetës për komunitetet në nevojë (rome & egjiptiane), të nxisë integrimin dhe fuqizimin e tyre.

Fushat e shërbimeve

- Shërbime psiko – sociale
- Shërbime ditore për fëmijët (passhkollore)
- Shërbime punësimi për të rinjtë
- Shërbime dhe aktivitete të edukimit shëndetësor

Llojet e shërbimeve

Shërbime psiko – sociale:

- Avokim, lobim, ndërgjegjësim për të drejtat e komunitetit, dhunën në familje, kujdesin shëndetësor, barazinë gjinore, etj.
- Lehtësim dhe ndërmjetësim për rritjen e qasjes ndaj shërbimeve sociale, administrative, etj.
- Organizim i aktiviteteve integruese, sociale dhe kulturore për fëmijët, gratë dhe të rinjtë.
- Trajnime të prindërve mbi prindërimin pozitiv.
- Ofrim i pakove ushqimore (në raste emergjente) për fëmijët/familjet.

Shërbime punësimi për të rinjtë:

- Program për aftësimin e jetës për të rinjtë 15-23 vjeç.
- Lehtësim për pjesëmarrje në kurse profesionale pranë Drejtorisë së Formimit Profesional (DFP).
- Ofrim i pagesës së transportit për pjesëmarrje në kurset e formimit profesional pranë DFP për të rinjtë (mbi 16 vjeç).
- Ofrimi i seteve profesionale për të rinjtë (mbi 16 vjeç) që përfundojnë një kurs profesional pranë DFP, për punësim dhe vetëpunësim.

Shërbime ditore për fëmijët (passhkollore):

- Programe passhkollore për fëmijët e moshës 6 -14 vjeç
- Kampe verore
- Kurse për shkrim-lexim dhe edukim bazë për vajzat, gratë dhe nënat e komuniteteve rome/egjiptiane në gjuhën shqipe.
- Shërbim biblioteke për fëmijët e zonës.

Shërbime dhe aktivitete të edukimit shëndetësor:

- Sensibilizim për higjienën personale dhe orale.
- Ofrim i paketave higjienosanitare dhe kiteve orale për anëtarët e komuniteteve rome/egjiptiane.
- Ndërgjegjësim për martesat në moshë të hershme dhe shërbime të planifikimit familjar.
- Informim i të rinjve mbi parandalimin e Infeksioneve Seksualisht të Transmetueshme.
- Informim dhe sensibilizim i nënave të reja për rëndësinë e ushqyerjes me gji.
- Ndërgjegjësim i fëmijëve, të rinjve dhe anëtarëve të komunitetit për ushqyerjen e shëndetshme.

GRUPET PËRFITUESE

Kategoritë përfituese

- Fëmijët
- Të rinjtë
- Gratë
- Familjet
- Komuniteti

Kriteret kualifikuese

- Banorë të Njesisë Administrative Nr. 5, Nishtullë
- Fëmijë dhe të rinj që përballen me sfida në shkollim dhe edukim, ose rrezik për braktisjen e shkollës.
- Gra që përballen me vështirësi ekonomike dhe sociale.
- Nëna të reja në nevojë mbështetjeje për kujdesin ndaj fëmijëve dhe qasjen në shërbime shëndetësore.
- Individë në nevojë për integrimin në shoqëri dhe tregun e punës.
- Familje që përballen me vështirësi ekonomike dhe sociale.
- Individë në nevojë për shërbime shëndetësore dhe sociale për të përmirësuar cilësinë e jetës.

Identifikimi i përfituesve

Përmes:

- Drejtorisë së Shërbimit Social në Bashki
- Qendrës Shëndetësore Nr. 7, Nishtullë
- Drejtorisë së Formimit Profesional
- Krehjes dhe vizitave në terren në Njësinë Administrative Nr. 5
- Organizatave jofitimprurëse

INFORMACION ADMINISTRATIV

- **Numri i punonjësve** ➤ 6 punonjës (1 drejtor, 1 punonjës social, 1 psikolog, 1 mësuese, 1 sanitarë, 1 roje)
- **Financuesi i shërbimit** ➤ Bashkia Durrës
- **Burime të tjera të ardhurash** ➤ Organizata Jofitimprurëse
- **Pagesa nga përfituesit** ➤ Nuk ka
- **Koordinimi me shërbime të tjera** ➤ Institucionet e listuara më lart tek “Identifikimi i përfituesve”
➤ Shkolla 9-vjeçare “Isuf Ferra”

○ Qendra Ditore Komunitare Multifunkzionale, Rrashbull

Lloji i institucionit Publik

Adresa Njësia Administrative Rrashbull, Bashkia Durrës
Facebook: [Qendra Komunitare Multifunkzionale Rrashbull](#)

Përfaqësues ligjor i institucionit **Kristiana Jorgji**
Cel.: 00355 69 56 14 268 | Email: kristiana.jorgji@gmail.com

Personi i kontaktit **Kristiana Jorgji**
Cel.: 00355 69 56 14 268 | Email: kristiana.jorgji@gmail.com

Mbulimi gjeografik Njësia Administrative Rrashbull (*Fshatrat: Rrashbull, Arapaj, Shënavlash, Shkallnur, Manskuri, Romanat, Bozanxhije, Xhafzotaj*)

Koha e ofrimit të shërbimit Prej vitit 2020

○ INFORMACION MBI LLOJIN E SHËRBIMEVE

○ **Qëllimi i shërbimit** ➤ Të nxisë përfshirjen sociale dhe zhvillimin e komunitetit.

○ **Fushat e shërbimeve** ➤ Shërbime ditore për fëmijët
➤ Shërbime psiko-sociale

○ **Llojet e shërbimeve** **Shërbime ditore për fëmijët:**
➤ Shërbime ditore passhkollore për fëmijët e moshës 6-15 vjeç (*ndihmë me detyrat e shtëpisë, ofrim i një vakti ushqimor, argëtim dhe socializim*).
➤ Programe për zhvillimin e aftësive jetësore për fëmijët dhe të rinjtë.
➤ Kampe verore për fëmijët dhe të rinjtë.

Shërbime psiko-sociale:
➤ Këshillim psikologjik për individët dhe familjet në nevojë.
➤ Vizita në familje për identifikimin e nevojave social-ekonomike dhe referimi i rasteve sipas nevojave.
➤ Program për forcimin e aftësive prindërore (klasat e prindërimit, grupet mbështetëse).
➤ Edukim shëndetësor për higjienën, ushqyerjen me gji, infeksionet seksualisht të transmetueshme, me mbështetjen e Qendrës Shëndetësore, Rrashbull.

GRUPET PËRFITUESE

- Kategoritë përfituese**
 - Fëmijët
 - Të rinjtë
 - Familjet dhe komuniteti
- Kriteret kualifikuese**
 - Banorë të Njesisë Administrative Rrashbull.
 - Fëmijë dhe të rinj nga familje me probleme social-ekonomike ose shëndetësore.
 - Fëmijë në rrezik për abuzim, neglizhencë ose shfrytëzim.
 - Të rinj në nevojë për zhvillim të aftësive për jetën.
 - Anëtarë nga komuniteti rom dhe egjiptian në nevojë për shërbime integruese.
- Identifikimi i përfituesve**

Përmes:

 - Njesisë së Vlerësimit dhe Referimit të Nevojave
 - Shërbimit Social në Njësine Administrative
 - Qendrës Shëndetësore Xhafzotaj-Rrashbull
 - Drejtorisë së Shërbimit Social në Bashkinë Durrës
 - Zyrës Vendore Arsimore dhe institucioneve në varësi
 - Referimit nga organizata jofitimprurëse

INFORMACION ADMINISTRATIV

- Numri i punonjësve**
 - 2 punonjës (1 drejtues teknik, 1 punonjës social (Specialist i Njesisë së Referimit dhe Vlerësimit të Nevojave)
- Financuesi i shërbimit**
 - Bashkia Durrës
- Burime të tjera të ardhurash**
 - Nuk ka
- Pagesa nga përfituesit**
 - Nuk ka
- Koordinimi me shërbime të tjera**
 - Institucionet e listuara më lart tek "Identifikimi i përfituesve"
 - Organizata Terre des Hommes
 - Organizata NISMA për ndryshim shoqëror ARSIS

Qendra e Shërbimeve Komunitare për Fëmijët me Aftësi të Kufizuara

Lloji i institucionit Publik

Adresa Rruga “Dalip Peza”, Lagjja 17, Durrës
Tel.: 00355 52 201845

Facebook: [Qendra Komunitare për Fëmijë me Aftësi të Kufizuara, Bashkia Durrës](#)

Përfaqësues ligjor i institucionit **Alda Agolli**
Cel.: 00355 68 41 65 130 | Email: agollialda@yahoo.com

Personi i kontaktit **Alda Agolli**
Cel.: 00355 68 41 65 130 | Email: agollialda@yahoo.com

Mbulimi gjeografik Qyteti i Durrësit

Koha e ofrimit të shërbimit Prej vitit 2016

INFORMACION MBI LLOJIN E SHËRBIMEVE

Qëllimi i shërbimit

- Të ofrojë rehabilitim të hershëm, gjithëpërfshirje dhe integrim për fëmijët me aftësi të kufizuara.

Fushat e shërbimeve

- Shërbime ditore rehabilituese në qendër (*rehabilitim të funksioneve fizike, verbale, shqisore, etj.*)
- Shërbime rehabilituese në banesë
- Shërbime psiko-sociale

Llojet e shërbimeve

Shërbime ditore rehabilituese:

- Terapi zhvillimore dhe e sjelljes për përmirësimin e aftësive njohëse dhe nxitjen e sjelljeve të përshtatshme.
- Terapi të të folurit (logopedi) për përmirësim të aftësive verbale dhe jo verbale.
- Fizioterapi dhe psikomotoricitet për përmirësimin e lëvizshmërisë, forcimin e muskulaturës, kockave, etj.
- Terapi okupacionale për përmirësimin e funksioneve të jetës së përditshme (veshja, higjiena, tualeti, ndjekja dhe kryerja e rutinave ditore).
- Mësimdhënie e përshtatur për rritjen e aftësive të të nxënit, leximit, shkrimit dhe kryerjen e veprimeve matematikore.
- Zhvillim të programeve të aftësisimit për jetën drejt jetesës së pavarur.

Shërbime rehabilituese në banesë:

- Shërbimet rehabilituese të lartpërmendura ofrohen në banesë për fëmijët 2-6 vjeç në pamundësi për të ndjekur programin në qendër.

Shërbime psiko-sociale:

- Informim, edukim dhe aftësim mbi llojin e terapive për prindërit/ kujdestarët me qëllim që të punojnë me fëmijët në shtëpi.
- Këshillim dhe mbështetje psikologjike për prindërit dhe familjarët në përgjigje të sfidave emocionale dhe sociale.
- Advokim, lobim dhe informim mbi gjithëpërfshirjen, mbështetjen, integrimin dhe të drejtat njerëzore të fëmijëve me AK (arsimim, jetesë e pavarur, pjesëmarrje, punësim, etj.).
- Ndërgjegjësim i komunitetit në promovimin e gjithëpërfshirjes dhe jetesës së pavarur për fëmijët me aftësi të kufizuara.

GRUPET PËRFITUESE

Kategoritë përfituese	➤ Fëmijët ➤ Të rinjtë ➤ Prindërit/ familjarët ➤ Komuniteti
Kriteret kualifikuese	➤ Fëmijë dhe të rinj me aftësi të kufizuara ➤ Të moshës 2-21 vjeç ➤ Me aftësi të kufizuara të shkallës së lehtë, të mesme dhe të mesme në të rëndë. ➤ Të aftë të lëvizin të pavarur, me ose pa karrocë me rrota. ➤ Pa probleme të rënda të sjelljes dhe shëndetit mendor, apo kriza të shpeshta të epilepsisë.
Identifikimi i përfituesve	Përmes: ➤ Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror, Durrës ➤ Drejtorisë së Shërbimit Social në Bashki ➤ Zyrës Vendore Arsimore dhe shërbimeve në varësi (shërbimi psiko-social dhe stafi mësimor në sistemin parashkollor dhe më lart) ➤ Shërbimeve të kujdesit shëndetësor parësor dhe spitalor ➤ Prindërve/familjes/komunitetit

INFORMACION ADMINISTRATIV

Numri i punonjësve	➤ 10 punonjës (1 drejtues, 1 logoped, 1 fizioterapeut, 2 terapistë, 2 psikologë, 2 punonjës socialë, 1 sanitar)
Financuesi i shërbimit	➤ Bashkia Durrës
Burime të tjera të ardhurash	➤ Organizata të shoqërisë civile (Save the Children, Ndihamoni Jetën, etj.) ➤ Donatorë të huaj (UNDP, etj.)
Pagesa nga përfituesit	➤ Nuk ka



Koordinimi me shërbime të tjera

- Institucionet e listuara më lart tek “Identifikimi i përfituesve”.
- Organizatat e shoqërisë civile

○ Kabineti i Onkologjisë dhe Kujdesit Paliativ, Spitali Rajonal Durrës

Lloji i institucionit	Publik
Adresa	Spitali Rajonal Durrës, Rruga "Telat Noga", Durrës
Përfaqësues ligjor i institucionit	Vodana Gjoka Email: spitalidurres@shendetesia.gov.al
Personi i kontaktit	Dr. Besmira Malaj Cel.: 00355 69 28 31 542 Email: besi_malaj@hotmail.com
Mbulimi gjeografik	Qarku Durrës (Bashkia Durrës, Shijak, Manëz, Sukth, Krujë, Fushë-Krujë dhe 10 NJA)
Koha e ofrimit të shërbimit	Prej vitit 2014

○ INFORMACION MBI LLOJIN E SHËRBIMEVE

- **Qëllimi i shërbimit**
 - Të ofrojë kujdes gjithëpërfshirës për pacientët me sëmundje tumorale dhe kronike.
- **Fushat e shërbimeve**
 - Shërbime shëndetësore (onkologjike dhe paliative) spitalore ditore
 - Shërbime shëndetësore (onkologjike dhe paliative) me shtretër, 24 orë
 - Shërbime psiko-sociale
- **Llojet e shërbimeve**

Shërbime shëndetësore:

 - Trajtim me kimioterapi venoze, orale dhe të kombinuara.
 - Trajtim paliativ për personat me diagnoza onkologjike.
 - Terapi mbështetëse mjekësore, ekzaminime laboratorike, radiologjike, konsulta në rastet kur pacienti paraqet efekte anësore nga trajtimi me kimioterapi.
 - Rikontrolle periodike të pacientëve të diagnostikuar me kancer.
 - Referime në qendra më të specializuara në rast nevojë.

Shërbime 24 orë:

 - Shtrime në Pavionin e Patologjisë për pacientët e diagnostikuar me kancer në nevojë për trajtime më tepër se 24 orë.

Shërbime psiko-sociale:

 - Mbështetje emocionale dhe psikologjike të pacientëve dhe familjarëve .
 - Referim tek psikiatri në rast nevojë ose konstatimi të problemeve të rënda psikologjike.
 - Ndjekje të rastit me këshillim dhe psikoterapi me pëlqimin e pacientit.

GRUPET PËRFITUESE

- Kategoritë përfituese** ➤ Popullata e qarkut Durrës
- Kriteret kualifikuese**
 - Persona me diagnozë onkologjike
 - Persona mbi 18 vjeç
 - Të referuar nga mjeku i familjes ose mjekët specialistë
 - Banues në qarkun Durrës
- Identifikimi i përfituesve** ➤ Nëpërmjet mjekut specialist onkolog

INFORMACION ADMINISTRATIV

